LIGJ
Nr.7726, datë 29.6.1993

PËR FONDIN ARKIVOR KOMBËTAR DHE PËR ARKIVAT

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në këtë ligj do të përdoren këto përcaktime:

Arkiva qendrore
Institucione shtetërore që përpunojnë, ruajnë dhe vënë në shfrytëzim dokumente të çdo lloji, të cilat përmbajnë të dhëna për historinë kombëtare. Përcaktohen me dispozita të Këshillit të Ministrave dhe janë në vartësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit.

Arkiva të sistemit
Institucione shtetërore që përpunojnë, ruajnë dhe vënë në shfrytëzim dokumente të çdo lloji, të një fushe të caktuar të veprimtarisë shoqërore dhe drejtojnë e përgjigjen për veprimtarinë arkivore të sistemit. Janë përcaktuar në nenin 15 të këtij ligji dhe varen nga ministria ose institucioni tjetër qendror i fushës përcaktuese.

Arkiva lokale
Institucione shtetërore që përpunojnë, ruajnë dhe vënë në shfrytëzim dokumente të çdo lloji, të cilat përmbajnë të dhëna për historinë e një njësie të caktuar administrative territoriale dhe drejtojnë e përgjigjen për veprimtarinë arkivore brenda saj. Përcaktohen me dispozita të Këshillit të Ministrave dhe varen nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Arkiva të organeve shtetërore e joshtetërore
Pjesë strukturore ose sektorë që përgjigjen për administrimin e dokumenteve të institucionit përkatës.

Arkiva të personave fizikë e juridikë privatë
Arkiva që administrohen prej personave të ndryshëm fizikë e juridikë privatë.

Neni 2

Fondi arkivor kombëtar shqiptar është tërësia e dokumenteve të krijuara gjatë veprimtarisë së organeve shtetërore e joshtetërore, të personave fizikë e juridikë privatë, pavarësisht nga koha, vendi, pronësia, mënyra e krijimit dhe lloji i tyre (dorëshkrim, shtypshkrim, vizatim teknik, fiksim figure në fotografi ose film, regjistrim zanor, regjistrim mekanografik), që shpallen me interes historik kombëtar.
Në fondin arkivor kombëtar shqiptar përfshihen edhe dokumentet me prejardhje nga institucionet e administratës shtetërore të huaj që ka vepruar në trojet shqiptare, si dhe dokumentet e organizatave, shoqatave e personaliteteve shqiptare që kanë ushtruar veprimtarinë në shtete të tjera e që ndodhen në arkivat e këtyre shteteve.
Fondi arkivor kombëtar shqiptar dhe arkivat mbrohen dhe sigurohen nga shteti, sipas kërkesave të këtij ligji.

Neni 3

Shteti shqiptar njeh detyrimet për mbrojtjen e trashëgimisë dokumentare që rrjedhin nga akte juridike ndërkombëtare, në të cilat ai është palë.

Neni 4

Dokumentet e organeve joshtetërore dhe të personave fizikë e juridikë privatë të hyra në arkivat shtetërore janë të paevokueshme, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është përcaktuar në marrëveshjen e hyrjes.

Neni 5

Fondi arkivor kombëtar shqiptar administrohet nga rrjeti arkivor i vendit, ku bëjnë pjesë arkivat shtetërore qendrore, lokale dhe ato të sistemit që miratohen ng Këshilli i Ministrave, si dhe arkivat e organeve shtetërore e joshtetërore dhe ato të personave fizikë e juridikë privatë.

Neni 6

Organi më i lartë arkivor i vendit është Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Ajo është institucion qendror në vartësi të Këshillit të Ministrave.

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është person juridik, ka vulën me stemën e Republikës së Shqiptërisë dhe me emërtimin e vet. Selia e saj ndodhet në Tiranë.

Neni 7

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka në vartësi të drejtpërdrejtë arkivat qendrore e lokale. Pranë saj veprojnë Këshilli i Lartë i Arkivave dhe Komisioni Qendror i Ekspertizës.

Veprimtaria e tyre ushtrohet në bazë të këtij ligji dhe të rregulloreve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 8

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë në të gjithë rrjetin arkivor të vendit.

Rregullat, udhëzimet dhe vendimet e nxjerra prej kësaj drejtorie në bazë e për zbatim të këtij ligji, janë të detyrueshme për të gjithë rrjetin arkivor të vendit.

Ajo nënshkruan marrëveshje dy a shumëpalëshe me institucionet homologe të vendeve të tjera për pasurimin e fondit arkivor kombëtar, shkëmbimin e përvojës, përgatitjen e kualifikimin e kuadrit.

Neni 9

Përcaktimi i fondeve arkivore që ruhen në arkivat shtetërore qendrore, lokale e të sistemit bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Në këto arkiva përfshihen vetëm dokumentet me afat ruajtjeje të përhershme (me rëndësi historike kombëtare), sipas listës tip të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Neni 10

Përcaktimi i vlerës dhe i afateve të ruajtjes së dokumenteve të organeve shtetërore bëhet nga komisionet e ekspertizës që funksionojnë pranë tyre dhe miratohen nga komisionet e ekspertizës të arkivave qendrore, lokale e të sistemit.

Asgjësimi i dokumenteve që humbasin vlerën e ruajtjes së mëtejshme, bëhet nga organet që i kanë ato në administrim, sipas rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Neni 11

Të gjitha organet shtetërore e joshtetërore dhe personat fizikë e juridikë privatë që kanë dokumente të përfshira në listën e dokumenteve me rëndësi historike kombëtare, dërgojnë të dhënat e nevojshme për t'u regjistruar në arkivat shtetërore qendrore, lokale dhe të sistemit, sipas përcaktimit që bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Neni 12

Arkivat e organeve shtetërore dhe joshtetërore dhe ato të personave fizikë e juridikë privatë, sipas përkatësisë, për dokumentet me rëndësi historike kombëtare, sipas kërkesave të këtij ligji dhe rregullave e akteve nënligjore janë të detyruar:

1. Të bëjnë sistemimin dhe inventarizimin e dokumenteve dhe t'u dërgojnë arkivave shtetërore përkatëse, qendrore, lokale e të sistemit ku janë regjistruar, dy ekzemplarë të inventarit të dosjeve dhe nga një ekzemplar të botimeve dokumentare të bëra prej tyre.

Inventarët depozitohen kur dorëzohen dokumentet në arkivat e mësipërme ose kur plotësohet afati për shfrytëzimin e tyre.

2. Të krijojë kushtet për sigurimin e ruajtjes fizike dhe teknologjike të dokumenteve.

3. Të bëjnë restaurimin e dokumenteve të dëmtuara nën udhëheqjen metodike, kontrollin dhe ndihmën e Arkivit Qendror të Shtetit.

4. Të lajmërojnë arkivat shtetërore, qendrore, lokale e të sistemit për dëmtimin e plotë ose të pjesshëm, humbjen dhe transferimin e dokumenteve në një vend tjetër.

5. Të mos tjetërsojnë dokumentet pa njoftuar më parë arkivin shtetëror përkatës qendror, lokal e të sistemit. Ky detyrim është i vlefshëm edhe në rastet e trashëgimisë. Dokumentet që ruhen në arkivat shtetërore, lokale e të sistemit nuk mund të tjetërsohen, me përjashtim të atyre që në marrëveshjen e dorëzimit nuk kanë ndryshuar pronësinë.

6. Të mos shesin ose eksportojnë në forma të tjera dokumentet jashtë shtetit pa autorizimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

7. Të organizojnë shfrytëzimin e dokumenteve. Organizimi i shfrytëzimit të dokumenteve të personave fizikë e juridikë privatë bëhet në bashkëpunim me arkivat shtetërore përkatëse qendrore, lokale e të sistemit.

Neni 13

Dokumentet dorëzohen për ruajtje dhe administrim në arkivat shtetërore qendrore, lokale dhe të sistemit të sistemuara dhe të inventarizuara sipas rregullave të caktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Neni 14

Dorëzimi i dokumenteve të organeve shtetërore në arkivat shtetërore qendrore, lokale e të sistemit bëhet sipa afateve të mëposhtme:

1. Dokumentet administrative pasi të kenë plotësuar 10 vjet nga viti i krijimit të tyre. Brenda këtij afat dorëzohen edhe dokumentet në figurë e në zë që hyjnë në përbërjen e dokumenteve administrative.

2. Dokumentet tekniko-shkencore, pas mbarimit të nevojave praktike, por jo më vonë se pas 25 vjetëve nga viti i krijimit të tyre.

3. Dokumentet në figurë e në zë pasi të kenë plotësuar 15 vjet nga viti i krijimit të tyre.

4. Regjistrat e akteve të gjendjes civile e të tjera të këtij lloji dhe dosjet e personaliteteve të rëndësishme, pasi të kenë plotësuar 75 vjet nga viti kur humbasin vlerën e përdorimit operativ të tyre nga aparati i administratës shtetërore përkatëse.

Neni 15

Dokumentet e krijuara gjatë veprimtarisë së Presidentit të Republikës, të Kuvendit Populllor, të

gjykatës e prokurorive, të Ministrisë së Mbrojtjes, të Shërbimit Informativ Kombëtar, të Ministrisë së Punëve të Jashtme e të Ministrisë së Rendit Publik, ruhen, administrohen dhe shfrytëzohen pranë arkivave të sistemit të tyre, duke respektuar kërkesat e këtij ligji.

Arkivi i ish-Ministrisë së Punëve të Brendshme ruhet i paprekur në arkivin e sistemit të Ministrisë së Rendit Publik.

Shfrytëzimi i tij vendoset në marrëveshje midis Ministrisë së Rendit Publik dhe SHIK-ut.

Kontrolli i zbatimit të këtij ligji në arkivat e këtyre organeve bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Neni 16

Dokumentet e organeve joshtetërore, të personave fizikë e juridikë privatë dhe ato të funksionarëve të lartë të shtetit, të personaliteteve politike, kulturore, shkencore të krijuara jashtë veprimtarisë së tyre shtetërore, që janë shpallur me interes historik kombëtar, dorëzohen në arkivat shtetërore qendrore, lokale e të sistemit sipas vullnetit të tyre ose të trashëgimtarëve e në marrëveshje me ta.

Neni 17

Arkivat shtetërore qendrore, lokale dhe të sistemit kanë të drejtën e grumbulluesit të parë të dokumenteve të organeve joshtetërore dhe të personave fizikë e juridikë privatë dhe janë të vetmet ndër organet shtetërore që kanë të drejtën e blerjes dhe të administrimit të dokumenteve të tyre.

Neni 18

Studiuesit shkencorë që bëjnë hulumtime për llogari të shtetit në arkivat e vendeve të tjera e marrin prej tyre origjinale ose kopje dokumentesh, janë të detyruar t'i dorëzojnë ato menjëherë sipas rregullave, në arkivin e institucionit ku punojnë dhe të dërgojnë në arkivat qendrore ose të sistemit një listë të hollësishme me sasinë dhe përmbajtjen e tyre.

Neni 19

Organet joshtetërore, personat fizikë e juridikë privatë që dhurojnë, lënë në trashëgim ose për ruajtje a u shesin dokumente arkivave shtetërore qendrore, lokale dhe të sistemit, gëzojnë të drejtën për të marrë, sipas marrëveshjes me to, riprodhime të tyre.

Neni 20

Në raste të ndryshimeve administrative territoriale, të riorganizimeve të veprimtarisë së organeve shtetërore etj., njoftohen Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe arkivat shtetërore qendrore, lokale e të sistemit, të cilat zgjidhin problemin e administrimit të dokumenteve të tyre.

Organet joshtetërore dhe personat fizikë e juridikë privatë, kur pushojnë veprimtarinë e tyre nuk ekzistojnë më dhe nuk kanë trashëgimtarë të njohur me ligj, dokumentet që ato disponojnë, kur ato janë të shpallura me interes historik kombëtar, detyrohen t'i depozitojnë në arkivat shtetërore qendrore, lokale e të sistemit.

Neni 21

Dokumentet e fondit arkivor kombëtar shqiptar shfrytëzohen për qëllime shkencore, ekonomike, social-kulturore e të veprimtarisë së administratës shtetërore, si dhe për sigurimin e mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitime të individëve.

Neni 22

Shfrytëzimi i dokumenteve të fondit arkivor kombëtar bëhet sipas dispozitave të këtij ligji

nëpërmjet:

1. Vënies në dispozicion të dokumenteve për studim në sallat e leximit të arkivave;

2. botimit të përmbledhjeve me dokumente;

3. organizimit të ekspozitave dokumentare; ekspozimi i dokumeteve origjinale lejohet vetëm në rastet kur atyre u sigurohet ruajtja fizike dhe teknologjike sipas rregullave në fuqi;

4. organeve të shtypit, radios, TV e kinematografisë;

5. njoftimit të organeve shtetërore e joshtetërore për probleme aktuale politike, ekonomike, shkencore, kulturore etj.;

6. dhënies së kopjeve të dokumenteve, sipas sasisë së caktuar nga titullari i arkivit që jep lejen për shfrytëzimin e dokumenteve;

7. plotësimit të kërkesave social-juridike të individëve.

Neni 23

Dokumentet e fondit arkivor kombëtar shqiptar si rregull jepen për shfrytëzim 25 vjet pas vitit të krijimit të tyre.

Disa kategori dokumentesh që përmbajnë të dhëna të rëndësishme për sigurimin e interesave të veçanta të shtetit, të përcaktuara nga institucionet fondkrijuese e të miratuara nga Këshilli i Ministrave, dosjet hetimore e gjyqësore dhe dokumentet që përmbajnë të dhëna për dinjitetin e individit, jepen për shfrytëzim pas 50 deri 150 vjet nga viti i krijimit të tyre.

Neni 24

Dokumentet e organeve të përmendura në nenin 15 dhe ato të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 23, jepen për shfrytëzim para afateve të përcaktuar në këtë ligj në raste të veçanta dhe vetëm me lejen e titullarit të tyre, kurse ato që ruhen pranë arkivave shtetërore qendrore e lokale vetëm me lejen e drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave dhe të titullarit të organit fondkrijues.

Neni 25

Publikimi i dosjeve të ish-sigurimit të shtetit bëhet me ligj të veçantë.

Neni 26

Arkivat shtetërore qendrore, lokale e të sistemit që ruajnë dokumente të organeve joshtetërore dhe të personave fizikë e juridikë privatë, në marrëveshje e sipas kërkesave të këtyre të fundit, mund të shtyjnë afatin e shfrytëzimit të dokumenteve të tyre dhe përtej afateve të caktuara në këtë ligj.

Neni 27

Shfrytëzimi nga shtetasit shqiptarë e të huaj të dokumenteve që ruhen pranë arkivave shtetërore qendrore, të sistemit e lokale, bëhet me lejë të drejtuesve të tyre.

Neni 28

Lejet për shfrytëzimin e dokumenteve para dorëzimit në arkivat shtetërore qendrore, lokale e të sistemit dhe plotësimit të afateve për të qenë të lira për shfrytëzim, jepen nga drejtuesit e organeve shtetërore vetëm për punonjësit e tyre e për nevoja të veprimtarisë së aparatit të tyre.

Neni 29

Dokumentet e fondit arkivor kombëtar që ruhen në arkivat shtetërore qendrore, lokale e të sistemit, shfrytëzohen për qëllime shkencore pa pagesë nga persona të autorizuar prej organeve shtetërore dhe nga personat fizikë e juridikë privatë.

Neni 30

Kërkesat e organeve shtetërore, joshtetërore dhe të personave fizikë e juridikë privatë për studime joshkencore, informata arkivore, kopje ose ekstrakte dokumentesh që ruhen në arkivat shtetërore qendrore, lokale e të sistemit, zgjidhen kundrejt pagesës, sipas tarifave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Neni 31

Drejtuesit dhe punonjësit e arkivave shtetërore qendrore, lokale e të sistemit dhe të organeve shtetërore e joshtetërore dhe personat fizikë e juridikë privatë mbajnë përgjegjësi ligjore për shkeljen e kërkesave të këtij ligji.

Shtetasit që hulumtojnë dokumente në arkiva, mbajnë përgjegjësi për publikimin e tyre në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 32

Kur nuk respektohen detyrimet sipas këtij ligji nga organet joshtetërore, personat fizikë e juridikë privatë, pronarë zotërues ose nëdorës të dokumenteve, u jepet një afat nga drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për të zbatuar dispozitat ligjore. Kur detyrimet nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, dokumentet e tyre merren për ruajtje nga arkivat shtetërore qendrore ose lokale. Në rast se organet shtetërore arkivore gjykojnë se ekziston rreziku i dëmtimit të menjëhershëm, që mund të sjellë zhdukjen e tyre, i marrin në administrim të tyre menjëherë.

Në të dy rastet ruhet e drejta e pronësisë dhe e rikthimit të dokumenteve.

Neni 33

Punonjës të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit dhe arkivat e sistemit për sistemin e tyre gjobitin 500 deri 2000 lekë personat përgjegjës kur:

a) Nuk krijojnë kushtet e nevojshme të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për ruajtjen fizike e teknologjike të dokumenteve.

b) Nuk zbatojnë kërkesat e këtij ligji dhe të rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve.

c) Nuk dorëzojnë brenda afateve dhe sipas kërkesave të këtij ligji dokumentet në arkivat shtetërore qendrore e lokale.

ç) Nuk u japin arkivave shtetërore qendrore e lokale të dhënat e nevojshme për regjistrimin e tyre dhe evidencimin e veprimtarisë arkivore e të dokumenteve të tyre.

d) Tjetërsojnë dokumentet pa miratimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

dh) Pengojnë punonjësit e autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për të ushtruar veprimtarinë e tyre të njohur nga ky ligj.

Personat fizikë privatë i nënshtrohen gjobës, kur nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në gërmat ç, d, dh.

Neni 34

Personat që humbasin dokumente të arkivit që kanë në administrim, dënohen me gjobë nga 2500 deri në 5000 lekë.

Asgjësimi i dokumenteve në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji, vjedhja si dhe humbja e atyre dokumenteve që janë të një rëndësie të veçantë, kur shkelja formon vepër penale, dënohet sipas Kodit Penal.

Neni 35

Kundër dënimit me gjobë mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit për kundërvajtjet administrative.

Neni 36

Masat e veçanta për mbrojtjen në kohë lufte të dokumenteve të gjithë rrjetit arkivor, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 37

Ligji nr.6893, datë 19.6.1984 "Për fondin arkivor të shtetit dhe për arkivat", shfuqizohet.

Neni 38

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.591, datë 6.7.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.